



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2017 – Numri: 242

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

**Tiranë – E mërkurë, 10 janar 2018**

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 821, datë 30.12.2017	Për një shtesë në vendimin nr. 929, datë 17.11.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, të ndryshuar..... 13367
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 27, datë 29.12.2017	Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë..... 13367
Udhëzim i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 618, datë 27.12.2017	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 17.2.2017, mbi zbatimin e vendimit nr. 955, datë 7.12.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”, të ndryshuar..... 13369
Udhëzim i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 619, datë 27.12.2017	Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr. 8, datë 25.2.2015, “Për planifikimin e fondeve për ndihmën ekonomike” ..... 13370
Udhëzim i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 620, datë 27.12.2017	Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 10.3.2014, “Për planifikimin e fondeve të pagesave për aftësinë e kufizuar” ..... 13372
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 209, datë 28.12.2017	Për miratimin e planit të investimeve për vitin 2017 për shoqërinë OSHEE sh.a. .... 13375
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 210, datë 28.12.2017	Për miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a. për vitin 2018..... 13381
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 211, datë 28.12.2017	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të OSHEE sh.a. për tarifatat e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike, sipas nivelit të tensionit dhe lënien në fuqi të çmimeve me pakicë për klientët që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal për vitin 2018..... 13383

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 212, datë 28.12.2017	Mbi miratimin e planit të investimeve për vitin 2017 dhe atë dhjetëvjeçar, 2015–2025, të zhvillimit të rrjetit të transmetimit të shoqërisë OST sh.a.....	13386
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 213, datë 28.12.2017	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e rregullores “Mbi kushtet specifike për ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të klientëve në nevojë” .....	13389

**VENDIM**

Nr. 821, datë 30.12.2017

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 929, DATË 17.11.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN DHE PËRDORIMIN E FONDIT TË VEÇANTË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 23.4.2011, “Për kompetencat për përcaktimin e pagave dhe të shpërblimeve” dhe të nenit 11, të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në fund të pikës 9, të vendimit nr. 929, datë 17.11.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Përjashtimisht për vitin 2017, Komisionerëve të Pavarur të Kualifikimit, Komisionerëve Publikë dhe Gjyqtarëve të Kolegjit të Pavarur të Apelit, u jepet një shpërblim, në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë.”.

2. Fondi prej 2 100 000 (dy milionë e njëqind mijë) lekësh përballohet nga fondi i veçantë i përdorur nga ministritë dhe institucionet qendrore, për vitin 2017.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe institucionet e rivlerësimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**

**UDHËZIM**

Nr. 27, datë 29.12.2017

**PËR STRUKTURAT E BRENDSHME AKADEMIKE DHE ADMINISTRATIVE NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 129, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”,

**UDHËZOJ:**

1. Struktura e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë të organizohet e ndarë për nga varësia hierarkike dhe institucionale.

2. Struktura akademike në nivel institucioni të konsiderohen:

- a) Senati akademik;
- b) Rektori;
- c) Rektori;
- d) Zëvendësrektor/ët.

3. Struktura ndihmësakademike me karakter administrativ në nivel institucioni të konsiderohen:

- a) Strukturat e kurrikulave;
- b) Strukturat e kërkimit shkencor;
- c) Strukturat e projekteve;
- d) Strukturat e promovimit akademik dhe botimeve;

- e) Strukturat e marrëdhënieve me publikun;
- f) Strukturat e marrëdhënieve me jashtë;
- g) Strukturat e sigurimit të brendshëm të cilësisë;
- h) Strukturat e karrierës;
- i) Strukturat e bibliotekave;
- j) Strukturat juridike;
- k) Strukturat e teknologjisë së informacionit;
- l) Strukturat e burimeve njerëzore;
- m) Strukturat e arkiv-protokollit;
- n) Asistent i rektorit.

4. Struktura administrative në nivel institucioni të konsiderohen:

- a) Bordi i administrimit;
- b) Administratori i institucionit;
- c) Strukturat e auditimit të brendshëm;
- d) Strukturat ekonomike;
- e) Strukturat e investimeve;
- f) Strukturat e prokurimeve;
- g) Strukturat e shërbimeve;



5. Struktura akademike në nivel njësie kryesore të konsiderohen:

- a) Asambleja e personelit akademik;
- b) Dekanati;
- c) Dekani;
- d) Zëvendësddekani/ët.

6. Struktura ndihmësakademike me karakter administrativ në nivel njësie kryesore të konsiderohen:

- a) Strukturat e sigurimit të brendshëm të cilësisë;
- b) Strukturat e karrierës;
- c) Strukturat e bibliotekave;
- d) Strukturat e burimeve njerëzore;
- e) Strukturat e arkiv-protokollit.
- f) Strukturat e teknologjisë së informacionit;
- g) Sekretaritë mësimore të njëjësive kryesore;
- h) Asistent i dekanit.

7. Struktura administrative në nivel njësie kryesore të konsiderohen:

- a) Administratori i njësisë kryesore;
- b) Strukturat ekonomike;
- c) Strukturat e shërbimeve;

8. Struktura akademike në nivel njësie bazë të konsiderohen:

- a) Drejtuesi i departamentit;
- b) Grupet mësimore/kërkimore shkencore që përbëhen nga jo më pak se 5, personel akademik, me kohë të plotë.

9. Struktura ndihmësakademike me karakter akademik në nivel njësie bazë të konsiderohen:

- a) Laborantët;
- b) Teknikët.

10. Struktura ndihmësakademike me karakter administrativ në nivel njësie bazë të konsiderohen:

- a) Sekretaritë në departamente (në rastet me mbi 21, personel akademik, në nivel njësie bazë me kohë të plotë).

11. Struktura administrative në nivel njësie bazë të konsiderohen:

- a) Administratori i njësisë bazë (në rastet me mbi 21, personel akademik, në nivel njësie bazë me kohë të plotë).

12. Me përjashtim të strukturave akademike dhe administrative të përcaktuara në ligjin 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, organizimi i strukturave të tjera, bëhet në varësi të numrit të përgjithshëm të personelit akademik

dhe atij administrativ, numrit të studentëve dhe buxhetit të institucionit publik të arsimit të lartë.

13. Në nivel institucional, strukturat e mësipërme me personel ndihmësakademik me karakter administrativ dhe personel administrativ organizohen në drejtori, sektorë dhe zyra, ku secila drejtori nuk mund të ketë më pak se dy sektorë apo zyra, secili sektor apo zyrë nuk mund të ketë më pak se tre specialistë.

14. Në nivel njësie kryesore, strukturat organizohen në degë dhe secila degë nuk mund të ketë më pak se dy punonjës.

15. Struktura akademike, ndihmësakademike, me karakter akademik dhe ndihmësakademike, me karakter administrativ, janë në varësi të rektorit të institucionit publik të arsimit të lartë. Strukturat akademike, ndihmësakademike, me karakter akademik dhe ndihmësakademike, me karakter administrativ, në nivel njësie kryesore, kanë varësi funksionale nga dekanat i njësisë kryesore përkatëse.

16. Struktura administrative është në varësi të administratorit të institucionit publik të arsimit të lartë. Struktura administrative në nivel njësie kryesore, ka varësi funksionale nga administratori i njësisë kryesore përkatëse.

17. Strukturat e auditimit të brendshëm janë në varësi të bordit të administrimit të institucionit publik të arsimit të lartë.

18. Strukturat juridike, burimeve njerëzore, arkiv-protokollit dhe teknologjisë së informacionit në nivel institucioni apo njësie kryesore, ushtojnë veprimtarinë e tyre në funksion të të gjitha strukturave në institucion.

19. Struktura organizative dhe organigrama e institucionit publik të arsimit të lartë, të jenë pjesë e statutit të institucioneve publike të arsimit të lartë, sipas kërkesave të nenit 33, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”.

20. Ngarkohen institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT  
DHE RINISË  
**Lindita Nikolla**



## UDHËZIM

Nr. 618, datë 27.12.2017

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME  
NË UDHËZIMIN NR. 3, DATË 17.2.2017,  
MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 955,  
DATË 7.12.2016, TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E  
KRITEREVE, TË PROCEDURAVE,  
DOKUMENTACIONIT DHE MASËS SË  
PËRFITIMIT TË NDIHMËS  
EKONOMIKE”, TË NDRYSHUAR**

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 43, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, dhe në zbatim të kreut IV, pika 2, të vendimit nr. 955, datë 7.12.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”,

## UDHËZOJ:

1. Në pikën 1 të udhëzimit fjalia e fundit shfuqizohet.

2. Pika 2 riformulohet me këtë përmbajtje:

“2. Aplikojnë për ndihmë ekonomike kryefamiljari i familjes/anëtarë madhor së bashku me bashkëshorten kur ka bashkëshorte, të cilët plotësojnë dhe nënshkruajnë aplikimin për familjen.”.

3. Në pikën 4 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Në pikën 4.1, germa “a”, në fund të fjalisë shtohet togfjalëshi “... dhe të anëtarëve të tjerë të familjes në moshë madhore”.

Në pikën 4.1, germa “b”, pas togfjalëshit “nga zyra e kadastrës” shtohet “në bashki/qark”.

Në pikën 4.2, pas germës “c” shtohet germa “ç” me këtë përmbajtje:

“ç) Vërtetim si punëkërkues i papunë, të lëshuar nga zyra e punës, për jetimet mbi moshën 18 vjeç.”.

Në pikën 4.3, germat “a” dhe “b” shfuqizohen.

Pas pikës 4.5 shtohet pika 4.6 me këtë përmbajtje:

“4.6. Pagesa e ndihmës ekonomike, për familjet dhe individët që përzgjidhen nëpërmjet Regjistrin Elektronik Kombëtar, do të fillojë në muajin që është kryer aplikimi pranë administratorit shoqëror.”.

4. Pika 5 shfuqizohet.

5. Në pikën 7 fjalia e parë riformulohet me këtë përmbajtje:

“7. Administratori shoqëror i konfirmon aplikuesit të dhënat e hedhura në aplikim për të vërtetuar saktësinë e informacionit.”.

6. Pika 9 riformulohet me këtë përmbajtje:

“9. Administratori shoqëror printon formularin e aplikimit i cili nënshkruhet nga administratori dhe aplikuesi dhe ruhet së bashku me dokumentacionin e dorëzuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ruajtjen e dokumentacionit.”.

7. Pika 13 riformulohet me këtë përmbajtje:

“13. Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, pas ardhjes së vendimit për propozim nga Këshilli i Bashkisë, verifikon të dhënat e hedhura në Regjistrin Elektronik Kombëtar dhe konfirmon saktësinë e tyre pranë autoriteteve shtetërore përgjegjëse.”.

8. Pika 14 riformulohet me këtë përmbajtje:

“14. Regjistri Elektronik Kombëtar do të kontrollojë në mënyrë të kryqëzuar automatikisht me sistemet e tjera të informacionit të dhënat e deklaruara nga aplikuesit/përfituesit e ndihmës ekonomike. Verifikimi i informacionit do të kryhet me këto institucione:

- a) Zyrat e punës;
- b) Zyrat e tatimeve;
- c) Zyrat e sigurimeve shoqërore;
- ç) Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme;
- d) Zyrat e regjistrimit të automjeteve;
- dh) Inspektorati i punës;
- e) Sektori pranë bashkive (urbanistikë, treg i lirë, bujqësi);
- ë) Gjykatës;
- f) Institucioneve të vuajtjes së dënimit me heqje lirie.”.

9. Pika 15 riformulohet me këtë përmbajtje:

“15. Në raste specifike, kur sistemi nuk e bën të mundur kryqëzimin e informacionit, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror do t'i drejtohet zyrtarisht çdo institucioni nga i cili kërkon të marrë informacion. Institucionet e përcaktuara në pikën 14 duhet të përgjigjen zyrtarisht brenda 10 ditëve.”.

10. Pas pikës 15 shtohet pika 15/1 me këtë përmbajtje:

“15/1. Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, pas verifikimit të të dhënave, cakton familjet/individët në nevojë, përfitues të ndihmës ekonomike ose refuzon familjet/individët që nuk



klasifikohen nga sistemi i pikëzimit si familje në nevojë dhe refuzon/përrjashton për një periudhë 6-mujore rastet e parashikuara në kreun II, pika 9 të vendimit nr. 955, datë 7.12.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike.”.

11. Pika 16 riformulohet me këtë përmbajtje:

“16. Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, pas verifikimit të të dhënave përcakton familjet/individët në nevojë, përfitues të ndihmës ekonomike ose refuzon familjet/individët që nuk klasifikohen nga sistemi i pikëzimit si familje në nevojë, si edhe refuzon/përrjashton për një periudhë 6-mujore rastet e parashikuara në kreun II, pika 9, të vendimit nr. 955, datë 7.12.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike.”.

12. Pas pikës 16 shtohet pika 16.1 me këtë përmbajtje:

“16.1. Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror gjeneron vendimin sipas aneksit nr. 3 që i bashkëlidhet këtij udhëzimi, për përfitimin e ndihmës ekonomike për familjet/individët përfitues, masën e përfitimit dhe për familjet/individët jopërfitues arsyen e refuzimit. Vendimi i dërgohet në mënyrë shkresore dhe në formë elektronike nëpërmjet Regjistrit Elektronik Kombëtar, Kryetarit të Bashkisë:

a) për të njoftuar kërkuesit për përfitimin e ndihmës ekonomike;

b) për të kryer veprimet financiare, për kryerjen e pagesës, për përfituesit e ndihmës ekonomike;

c) për të njoftuar kërkuesit për refuzimin e ndihmës ekonomike me argumentet përkatëse.”

13. Në pikën 17 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Në germën “a”, pas togfjalëshit “të anëtarëve të familjes” shtohet togfjalëshi “që jetojnë në të njëjtën strehë”.

Në germën “b” togfjalëshi “një afati 10-ditor” zëvendësohet me togfjalëshin “10 ditë pune” dhe në fund të fjalisë shtohet “... të vërtetuara me dokumentacionin përkatës”.

Germa “ç” riformulohet me këtë përmbajtje:

“ç) Fsheh informacionin apo kryen deklaram të rremë mbi të dhënat e kërkuara në pikën 1, germa “a”, të kreut II, të vendimit nr. 955, datë

7.12.2017, të Këshillit të Ministrave.”.

Germa “d” riformulohet me këtë përmbajtje:

“d) Nuk paraqiten anëtarët madhorë të familjes/nuk deklarohen ndryshimet e situatës social-ekonomike në deklaratën e paraqitjes çdo tre muaj të familjes.”.

Germa “e” riformulohet me këtë përmbajtje:

“e) Anëtarët në moshë aktive pune të aftë për punë që nuk rezultojnë punëkërkuar të papunë, pranë zyrave të punës apo të vetëpunësuar pranë strukturave të tatimeve, me përjashtim të rasteve të familjeve që zotërojnë tokë bujqësore në pronësi/përdorim.”.

14. Pas pikës 17 shtohet pika 17/1 me këtë përmbajtje:

“17/1 Bashkëshortja është përgjegjëse për tërheqjen dhe marrjen në dorëzim të përfitimit të ndihmës ekonomike. Për rastet kur në strukturën e familjes bashkëshortja mungon, të drejtën e tërheqjes së ndihmës ekonomike e ka kryetari i familjes/anëtari madhor.”.

15. Pika 18 riformulohet me këtë përmbajtje:

“18. Anëtarët madhorë të familjes/individët përfitues të ndihmës ekonomike paraqiten dhe plotësojnë çdo 3 (tre) muaj deklaratën lidhur me gjendjen social-ekonomike pranë administratorit shoqëror, nga data 1–10 të muajit. Administratori shoqëror hedh në Regjistrin Elektronik Kombëtar deklaratën lidhur me ndryshimet social-ekonomike të familjes sipas shtojcës 3, të vendimit nr. 955, datë 7.12.2016, të Këshillit të Ministrave.”.

16. Në pikën 19 pas togfjalëshit “dokumentacionit të ndihmës ekonomike” shtohet “fizikisht dhe nëpërmjet Regjistrit Elektronik Kombëtar nga administratori shoqëror.”.

17. Në pikën 19/3 togfjalëshi “duhet të kryejë kontrollin mjekësor bazë” zëvendësohet me “ka të drejtë të kryejë kontrollin mjekësor bazë”.

18. Pika 19/4 shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE  
**Ogerta Manastirliu**



## UDHËZIM

Nr. 619, datë 27.12.2017

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA  
NË UDHËZIMIN NR. 8, DATË 25.2.2015,  
“PËR PLANIFIKIMIN E FONDEVE PËR  
NDIHMËN EKONOMIKE”**

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 35, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 2, datë 6.2.2012, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”,

## UDHËZOJ:

1. Në pikën 1 të udhëzimit togfjalëshi “Administratori shoqëror në bashki/komunë” zëvendësohet me “Struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki”.

2. Pas pikës 2 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki programon kërkesat për fondin deri në 6% të bllok-ndihmës ekonomike dhe i dërgon në zyrat rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.”.

QARKU \_\_\_\_\_

BASHKIA \_\_\_\_\_

3. Pika 2 riformulohet me këtë përmbajtje:

“2. Programimi i fondeve për ndihmën ekonomike mbështetet në numrin e popullsisë gjithsej, numrin e familjeve, vlerësimin e varfërisë dhe numrin e familjeve në ndihmë ekonomike, strukturën e anëtarëve të familjes (anëtarin e parë të familjes sipas renditjes në certifikatën familjare, anëtarët e familjes mbi moshën 18 vjeç, anëtarët e familjes në dhe nën moshën 18 vjeç, anëtarin e vetëm mbi moshë pune); personat që kanë statusin e jetimit; numrin e familjeve që kanë fëmijë të lindur njëherësh, si: trinjakë, katërnjakë apo pesënjakë, viktimat të trafikimit, viktimat të dhunës në familje, fëmijë në familje kujdestare, fëmijë që ndjekin arsimin e detyrueshëm, numri i vaksinave për fëmijët e vaksinuar të familjeve në NE.”.

4. Në pikën 3, moduli 1 ndryshon sipas formatit që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

5. Kudo në udhëzim togfjalëshi “bashki/komunë” zëvendësohet me “bashki” dhe “Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë” zëvendësohet me “ministria përgjegjëse për çështjet sociale”.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I SHËNDETTËSISË DHE  
MBROJTJES SOCIALE  
Ogerta Manastirliu

Moduli 1

Programimi i fondeve për shpërndarjen e ndihmës ekonomike

Datë, më \_\_\_\_\_

Nr.	Emërtimi	Struktura në numër	Masa e pagesës	Fondi i ndihmës ekonomike
1	Popullsia gjithsej			
2	Familje gjithsej			
3	% e familjeve në skemë			
-	Familje në skemë e ndarë kjo			
4	Anëtar i parë i familjes sipas renditjes në certifikatën familjare			
5	Anëtarët e familjes mbi moshën 18 vjeç			
6	Anëtarët e familjes në dhe nën moshën 18 vjeç			
7	Anëtar i vetëm mbi moshë pune			
8	Jetim 18–25 vjeç			
9	Jetim mbi 25 vjeç			
10	Numri i fëmijëve 3-njakë të familjeve			



11	Numri i fëmijëve 4-njakë të familjeve			
12	Numri i fëmijëve 5-njakë të familjeve			
13	Viktima të dhunës			
14	Viktima të trafikimit			
15	Komp. energjie për familjet në skemë			
16	Komp. energjie për heqjen e fashës deri 300 kwh për familjet në NE			
17	Fëmijë deri në moshën 16 vjeç që ndjekin arsimin e detyrueshëm 9-vjeçar (janar – qershor; shtator – dhjetor)			
18	Numri i vaksinave për fëmijët në familjet përfituese të NE-së			
19	Fëmijë në familje kujdestare			
20	Fëmijë me AK në familje kujdestare			
21	Nr. i fëmijëve në familje kujdestare që përfitojnë shpenz. veshje + indirekte			
22	Nr. i fëmijëve në familje kujdestare që përfitojnë shpenz. shkolle			
<b>A</b>	<b>Fondi sipas strukturës: A = (4+5+6+7)*12 muaj</b>			
<b>B</b>	<b>Fondi për individë e kompensime:</b> {(8+9+10+11+12+13+14+15+16+19+20) x 12 muaj} + (17*10) +(18*1)+( 21*1) + (22*1)			
<b>C</b>	<b>Fondi 6%</b>			
<b>D</b>	<b>Fondi gjithsej D= ( A + B+C )</b>			

DREJTORI

KRYETARI

Vula

## UDHËZIM

Nr. 620, datë 27.12.2017

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN  
NR. 3, DATË 10.3.2014, “PËR  
PLANIFIKIMIN E FONDEVE TË  
PAGESAVE PËR AFTËSINË E  
KUFIZUAR”**

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, të pikës 27, të vendimit nr. 618, datë 7.9.2006 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuara”, të ndryshuar, të vendimit nr. 277, datë 18.6.1997, të Këshillit të Ministrave, “Për përfitimet nga statusi i të verbrit”, të ndryshuar, të vendimit nr. 31, datë 20.1.2001, të Këshillit të Ministrave, “Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, të ndryshuar, vendimit nr. 431, datë 8.6.2016, “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit, procedurave dhe të

Faqe | 13372

masës për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre në zonat pilot” dhe të pikës 11, të vendimit nr. 404, datë 20.6.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës, të kriterëve e të procedurave të përfitimit të kompensimit financiar, nga personat me statusin e të verbrit, dhe invalidit paraplegjik e tetraplegjik, për faturën e energjisë elektrike dhe faturën e telefonisë fikse”, të vendimit nr. 8, datë 14.1.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë nga heqja e fashës deri në 300 kwh për faturimin e çmimit të energjisë elektrike”, të udhëzimit nr. 2, datë 6.2.2012, të Ministrisë së Financave, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”,

## UDHËZOJ:

1. Në pikën 1 të udhëzimit togfjalëshi “Administratori shoqëror në bashki/komunë” zëvendësohet me “Struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki”.

2. Në pikën 2 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Programimi i fondeve për personat me aftësi të kufizuara në njësitë administrative në të cilat po





pilotohet vlerësimi biopsikosocial bëhet në përputhje me vendimin nr. 431, datë 8.6.2016, “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit, procedurave dhe të masës për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre në zonat pilot” dhe udhëzimin nr. 22 datë 7.10.2016, “Mbi përcaktimin e masës për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal.”.

3. Në fund të pikës 3 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Të dhënat për bashkitë ku pilotohet vlerësimi biopsikosocial i aftësisë së kufizuar plotësohen

**QARKU** \_\_\_\_\_

**BASHKIA** \_\_\_\_\_

sipas modulit 2, rubrikat V, VI, VII dhe VIII, bashkëlidhur këtij udhëzimi.”.

4. Kudo në udhëzim togfjalëshi “bashki/komunë” zëvendësohet me “bashki” dhe “Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë” zëvendësohet me “ministra përgjegjëse për çështjet sociale”.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE  
**Ogerta Manastirliu**

Moduli 1

Programimi i fondeve për pagesat e aftësisë së kufizuar

Datë, më \_\_\_\_\_

Nr.	Emërtimi	Numri i personave PAK	Masa e pagesës	Fondi vjetor
<b>I</b>	<b>Personat me aftësi të kufizuara, gjithsej (a+b+c) + kujdestar + kompensimet</b>			
<b>1</b>	<b>Me aftësi të kufizuara mendore, fizike, gjithsej (a+b+c)</b>			
a	100%			
b	200%			
c	300%			
<b>d</b>	<b>Kujdestarë gjithsej</b>			
	100%			
	150%			
<b>2</b>	<b>Kompensimet</b>			
	Komp. të energjisë elektrike për PAK-në gjithsej			
	Komp. për heqjen e fashos për PAK-në gjithsej			
<b>II</b>	<b>Të verbër gjithsej (a+b+c+d) + kujdestar</b>			
<b>2</b>	<b>Të verbër gjithsej (a+b+c+d)</b>			
a	100%			
b	150%			
c	200%			
d	300%			
	<b>Kujdestarë gjithsej</b>			
	Kompensim energjie për të verbër me kujdestar			
	Kompensim energjie për të verbër pa kujdestar			
	Kompensim telefoni për të verbër gjithsej			
	Kompensim për heqjen e fashës deri 300 kwh			
<b>III</b>	<b>Para- e tetraplegjik + kujdestar + paketë HS</b>			
<b>3</b>	<b>Para- e tetraplegjik gjithsej</b>			
a	100%			
b	200%			
c	300%			
<b>d</b>	<b>Kujdestarë gjithsej</b>			
	100%			
	150%			
<b>e</b>	<b>Paketa higjieno-sanitare</b>			
	Komp. energjie para- e tetraplegjik me kujdestar			



	<b>Komp. energjie para- e tetraplegjik pa kujdestar</b>			
	<b>Kompensim telefoni për para- e tetraplegjik gjithsej</b>			
	<b>Kompensim për heqjen e fashës deri në 300 kwh</b>			
<b>IV</b>	<b>Nr. i invalidëve gjithsej (a+b+c+d)</b>			
<b>a</b>	Sëmundje e përgjithshme, grupi I			
<b>b</b>	Sëmundje e përgjithshme, grupi II			
<b>c</b>	Sëmundje profesionale, grupi I			
<b>d</b>	Sëmundje profesionale, grupi II			
<b>V</b>	<b>Personat me aftësi të kufizuara, gjithsej (të rritur + fëmijë + ndihmës personal + paketë higjiëno-sanitare)<sup>1</sup></b>			
<b>VI</b>	<b>Persona me aftësi të kufizuara (të rritur): (a+b+c+ç+d+dh+e+ë+f+g+h)</b>			
<b>a</b>	<b>Të rritur me kufizime të lehta (100%)</b>			
<b>b</b>	Të rritur me kufizime të lehta (150%) <sup>2</sup>			
<b>c</b>	Të rritur me kufizime të lehta (200%) <sup>3</sup>			
<b>ç</b>	<b>Të rritur me kufizime mesatare (100%)</b>			
<b>d</b>	Të rritur me kufizime mesatare (150%)			
<b>dh</b>	Të rritur me kufizime mesatare (200%)			
<b>e</b>	<b>Të rritur me kufizime të thella (100%)</b>			
<b>ë</b>	Të rritur me kufizime të thella (150%)			
<b>f</b>	Të rritur me kufizime të thella (200%)			
<b>g</b>	<b>Të rritur me kufizime të rënda (100%)</b>			
<b>gj</b>	Të rritur me kufizime të rënda (150%)			
<b>h</b>	Të rritur me kufizime të rënda (200%)			
<b>VII</b>	<b>Persona me aftësi të kufizuara (fëmijë): (a+b+c+ç+d+dh+e+ë+f+g+h)</b>			
<b>a</b>	<b>Fëmijë me kufizime të lehta (100%)</b>			
<b>b</b>	Fëmijë me kufizime të lehta (150%) <sup>4</sup>			
<b>c</b>	Fëmijë me kufizime të lehta (200%) <sup>5</sup>			
<b>ç</b>	<b>Fëmijë me kufizime mesatare (100%)</b>			
<b>d</b>	Fëmijë me kufizime mesatare (150%)			
<b>dh</b>	Fëmijë me kufizime mesatare (200%)			
<b>e</b>	<b>Fëmijë me kufizime të thella (100%)</b>			
<b>ë</b>	Fëmijë me kufizime të thella (150%)			
<b>f</b>	Fëmijë me kufizime të thella (200%)			
<b>g</b>	<b>Fëmijë me kufizime të rënda (100%)</b>			
<b>gj</b>	Fëmijë me kufizime të rënda (150%)			
<b>h</b>	Fëmijë me kufizime të rënda (200%)			
<b>VIII</b>	<b>Ndihmës personal gjithsej dhe paketë higjiëno-sanitare (a+b+c)</b>			
<b>a</b>	Shërbime gjithëpërfshirëse			
	Shërbime të herëpashershme			
<b>b</b>	Shërbime gjithëpërfshirëse 150% e më shumë			
<b>c</b>	Shërbime të herëpashershme 150% e më shumë			
<b>ç</b>	<b>Paketë higjiëno-sanitare</b>			
	<b>TOTALI I PAK-së</b>			

DREJTORI

Vula

KRYETARI

<sup>1</sup> Për t'u plotësuar vetëm nga njësitë e pilotimit të vlerësimit biopsikosocial.

<sup>2</sup> Të rritur që ndjekin arsimin/formimin profesional.

<sup>3</sup> Të rritur që ndjekin arsimin/formimin profesional dhe janë nga familje në ndihmë ekonomike.

<sup>4</sup> Fëmijë që ndjekin arsimin/formimin profesional.

<sup>5</sup> Fëmijë që ndjekin arsimin/formimin profesional dhe janë nga familje në ndihmë ekonomike.

**VENDIM****Nr. 209, datë 28.12.2017****PËR MIRATIMIN E PLANIT TË  
INVESTIMEVE PËR VITIN 2017 PËR  
SHOQËRINË OSHEE SHA**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 20, geramat “a” dhe “e”; të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe nenit 15, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; neneve 6; 7; 8; 10; 11; 12 dhe 13, të rregullores “Për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”; miratuar me vendimin nr. 62, datë 15.9.2009; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për miratimin e planit të investimeve për vitin 2017, për kompaninë OSHEE sh.a., të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut; Drejtoria e Çmimit dhe Tarifave dhe Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

- “Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike” sh.a., në shkresën me nr. 23480 prot., datë 14.10.2016, ka paraqitur pranë ERE-s, një studim lidhur me “Planin ekonomik-financiar për vitin 2017”.

- Grupi i punës i ngritur me urdhrin nr. 62, datë 2.11.2016 të kryetarit të ERE-s, shqyrtoi dokumentacionin e dërguar nga kompania, nëpërmjet shkresës së sipërcituar dhe konstatoi që ajo nuk mund të konsiderohej kërkesë për miratimin e planit të investimeve për vitin 2017 (konform nenit 11, të rregullores “Për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”).

- ERE me anë të shkresës nr. 726/1, datë 3.11.2006 drejtuar OSHEE sh.a., i kërkoi kësaj të fundit, paraqitjen e kërkesës për miratimin e planit të investimeve për vitin 2017, në përputhje me nenin 11, të rregullores “Për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin nr. 62, datë 15.9.2009, të bordit të ERE-s.

- Me anë të shkresës nr. 1106 prot., datë 30.1.2017, OSHEE sh.a. ka paraqitur informacion lidhur me planin e investimeve që pritet të

realizohet në periudhën 2017–2021.

- Gjithashtu, në kuadër të aplikimit për përcaktimin e tarifës për nivel tensioni, janë kërkuar sqarime lidhur me vlerën totale të “Planit të investimeve 2017”, me anë të shkresës nr. 23 prot., datë 13.1.2017, pasi vlera e investimeve ishte më e lartë në aplikimin për tarifën sipas tensioneve.

- OSHEE sh.a., në shkresën e saj me nr. 1106/1 prot., datë 30.1.2017, përcakton se: Paraqitja e planit të investimeve me anë të shkresës nr. 23480 prot., datë 14.10.2016, është vetëm një draft dhe plani i ndryshuar i investimeve ndodhet bashkëlidhur.

- Grupi i punës konstatoi se ajo që paraqitet bashkëlidhur kësaj shkrese, është relacion mbi ndryshime të bëra, duke sqaruar edhe arsyet duke u paraqitur si ndryshime të planifikimit ekonomik-financiar. Vlera e investimeve të parashikuara paraqitet me një shtesë për vitin 2017 me 1 615 174 076 lekë.

- ERE, me anë të shkresës nr. 274, datë 30.3.2017, i ka rikërkuar OSHEE sh.a. paraqitjen për miratim të planit të investimeve, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

- Bordi i ERE-s, në vendimit nr. 91, datë 4.7.2017, vendosi: Fillimin e procedurave për miratimin e “Planit të investimeve për vitin 2017 të OSHEE sh.a”.

- Me anë të shkresës me nr. 503 prot., datë 12.7.2017, ERE kërkoi paraqitjen për miratim të planit të përditësuar pas ndryshimeve të ndodhura në kuadrin ligjor dhe ndryshimeve të mundshme për shkak të emergjencave.

- Nga ana e OSHEE sh.a. nuk u morën masa për paraqitjen e planit të përditësuar dhe ERE, me anë të shkresës nr. 725 prot., datë 8.11.2017, kërkoi edhe një herë dërgimin për miratim të planit të investimeve, brenda datës 15.11.2017 dhe në të kundërt njoftoi se do të nisin procedurat për masa administrative sipas parashikimeve të nenit 107, germa “g”, të ligjit 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

- Me anë të shkresës nr. 26937 prot., datë 15.12.2017, OSHEE sh.a. ka dërguar “Kërkesë për miratimin e planit të investimeve për vitin 2017”.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s



## VENDOSI:

1. Miratimin e “Planit të investimeve të OSHEE sh.a. për vitin 2017” në vlerën 12 555 266 570 lekë, me fondet e veta dhe 3 467 648

000 lekë me huan e Bankës Botërore.

2. OSHEE sh.a. duhet të paraqesë planin e përditësuar të investimeve për vitin 2018 dhe atë të zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes për pesë vitet e ardhshme kalendarike, sipas përcaktimeve të nenit 75, të ligjit 43/2015 dhe “Rregullores së procedurave të paraqitjes dhe të miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë

elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 135, datë 6.9.2017.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorëve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Petrit Ahmeti

## PLANI I INVESTIMEVE, VITI 2017, OSHEE SHA (LEKË)

Nr.	Emërtimi i investimit	Me fonde të OSHEE sh.a.	Hua nga Banka Botërore
<b>I</b>	<b>Ndërtim/rikonstruksion elektrik për nënstacionet</b>	<b>833,635,887</b>	<b>1,019,280,000</b>
1	Rikonstruksioni i nënstacionit Gjirokastër	125,000,000	
2	Fuqizimi i nënstacionit të Selitës	250,000,000	
3	Shtesë kontrate në “Fuqizimi i nënstacionit të Selitës”	55,000,000	
4	Ndërtimi i nënstacionit të ri Dhërmi 35/20/10 kV	10,000,000	
5	Fuqizim i nënstacionit të Traktorëve 110/35/20/6	80,000,000	
8	Spostimi i nënstacionit të Farkës 110/20/10 kV	29,735,887	
9	Rikonstruksion i nënstacionit të Zogu të Zi (kthimi nga 35/6 kV në 35/20 kV)	83,900,000	
12	Nënstacionit lëvizës 110/20 kV (TR 40 MVA)	200,000,000	
13	Furnizim dhe instalim në nënstacion (Tirana Kombinat)		411,000,000
14	Furnizim dhe instalim në nënstacion (Tirana Qendër 1)		608,280,000
<b>II</b>	<b>Ndërtim/Rikonstruksion linjash të TL-së</b>	<b>476,828,204</b>	<b>0</b>
1	Rikonstruksionin i linjës 35 kV Bistricë -Sarandë	30,000,000	
2	Ndërtim i linjës dyfishe 20 kV (shfrytëzim me një qark) Himarë – Qeparo – Borsh – Bunec, ndërtimi i kabinave elektrike, si dhe rrjet TU me përcjellës ABC	147,000,000	
3	Rikonstruksion i rrjetit kabllor 35 kV i furnizimit të nënstacionit të Kongreseve	80,000,000	
4	Furnizimi i ri me 110/20 kV i Velipojës dhe ndërtimi i pikës shpërndarëse 110/20 kV	40,000,000	
5	Salla baterish për nënstacionet e tensionit të lartë	160,000,000	
6	Rikonstruksioni i nënstacionit Lezhë	19,828,204	
<b>III</b>	<b>Blerje pajisje makinerish për nënstacionet dhe likuidim avarish</b>	<b>200,000,000</b>	<b>516,851,000</b>
1	Blerje makineri pajisje për nënstacione	20,000,000	
2	Transformator fuqie për nënstacione	70,000,000	
3	Çela për nënstacione	90,000,000	
4	Pajisje testuese	20,000,000	
5	Shtylla betoni për linjat TU (10,000 copë)		81,652,000
6	Blerje kabloje të tensionit të mesëm dhe tensionit të ulët		435,199,000
<b>IV</b>	<b>Ndërtim rrjeti TM</b>	<b>78,233,000</b>	
1	Inspektimi dhe konformiteti për pajisjet dhe instalimet elektrike Mbikëqyrja e fushës elektromagnetike në nënstacione dhe kabina elektrike	78,233,000	
<b>V</b>	<b>Ndërtim/rikonstruksion rrjeti TM/TU</b>	<b>6,795,838,054</b>	<b>0</b>



1	Rikonstruksioni i linjës TM, kablo elektrike dhe rrjet ABC fideri, Dropulli i Sipërm, Gjirokastër	100,000,000	
2	Ndërtimi i linjës TM, për furnizimin e Stacionit të Policisë Kufitare Sopik	7,528,984	
3	Ndërtim rrjeti TU me kablo ABC, kabinat e fiderit nr. 7 (10 kV), nënstationi Kuçovë	36,000,000	
4	Ndërtimi i rrjetit TU me kablo ABC fideri nr. 8 (10 kV), nënstationi Kuçovë	21,122,048	
5	Investime rrjet TM/TU loti I, Lushnjë (lista analirike mars 2017)	21,947,271	
6	Ndërtimi i fiderit A5 20 kV Berat dhe kabinave dhe rrjetit TU me kablo ABC	27,633,255	
7	Zhvillimi i rrjetit 20 kV kabinave 20/0.4 kV dhe i rrjetit ABC, në zonën e Bushatit	450,608,256	
8	Projekti “Lidhja unazore e fiderave 20 kV 12, Shkodra 1 me 12, Shkodra 2/nënstationi 110/35/20/6 kV Shkodra 2”	13,836,685	
9	Ndërtim i linjës kabllore dhe kabinës “Box stacioni i pompave”, F-6, Velipojë	13,133,704	
10	Ndërtim rrjeti TM/TU me kablo me vetëmbajtje ABC, Shkodër	18,000,000	
11	Ndërtim rrjeti TM 20 kV, ndërtim kabinash elektrike, si dhe rrjet TU me përcjellës ABC, Tamarë	5,000,000	
12	Ndërtim i linjës TM/TU, si dhe i kabinës “Box Murgesha”, F-12, SH-1, Shkodër	4,000,000	
13	Ndërtim i linjës TM/TU, si dhe i kabinës shtyllore “Velipojë 15”, F-6, nënstationi Velipojë, Shkodër	3,000,000	
14	Rikonstruksion i kabinës murore dhe rrjetit TM/TU “Grumbullimi”, fideri i qytetit Pukë	5,291,723	
15	Rikonstruksion i rrjetit TU me kablo ABC në disa kabina të fiderave 20 kV nënstationi Bogic, Koplik, Shkodër	19,373,164	
16	Linjë TM/TU me kablo 20 kV XLPE, Al 3x1x195 mm <sup>2</sup> , Box i ri “Gjuraj 1”, “Murorë Koplik i Sipërm 1”	42,946,665	
17	Ndërtimi i rrjetit TM 20 kV, si dhe kabina e re “Box Prefektura”, rikonstruksion i rrjetit TU dhe i kabinës ZVRPP, Lezhë	10,675,132	
18	Zgjatimi i fiderit 7, Sallmone, segmenti nga “Lura-2” deri te “Primavera”, si dhe ndërtimi i kabinave elektrike me daljet e para	32,918,548	
19	Zgjerim rrjeti 20 kV në Sektor Rinia me dalje të re F.16 Sp. nga nënstationi Spitalë, me linjë kabllore nëntokësore me kabina të reja 20 kV dhe rrjeti TU	226,111,000	
20	Zgjerim rrjeti 20 kV në Kodër-Arapaj me dalje të re F.55S nga nënstationi Shkozë, me linjë kabllore nëntokësore me kabina të reja 20 kV dhe rrjeti TU	204,400,000	
21	Përmirësimi i shpërndarjes së fuqisë në fiderat e zonës së plazhit, duke ndërtuar dy fidera të rinj F.56, 57 nga nënstationi Shkozë	60,000,000	
22	Zgjerimi i rrjetit 20 kV në Vërrinë me kabina të reja dhe rrjet TU	110,000,000	
23	Zhvillimi i rrjetit 20 kV në Shkëmbin e Kavajës me kabina të reja dhe rrjet TU	95,000,000	
24	Zgjatimi i fiderit 20 kV, F.7 Sp. dhe bërja e tij unazë me fiderin F.2 Sp., si dhe rikonstruksioni i rrjetit TU për kabinat 20 kV K.151/4, K.151/5	30,000,000	
25	Demontimi i kabinave “ishull” 6 kV në fiderat 20 kV nr. 2 Sp., nr. 4 Sp. dhe nr. 10 Sp., nënstationi Spitalë	54,000,000	
26	Ndërtimi i degëzimit të F.45 të nënstationit Shkozë dhe ndërtimi i 4 kabinave elektrike dhe i rrjetit TU	90,000,000	
27	Zgjatim fideri 20 kV për në zonën industriale me linjë kabllore nëntokësore, ndërtim kabina të reja tip Box si dhe ndërtim rrjeti TU-Kavajë	39,400,000	
28	Rikonstruksion kabina elektrike dhe rrjeti TU në Agjencinë Kavajë	165,500,000	
29	Ndërtim i kabinave të reja 10/6 kV me rrjetin TU të tipit ABC për Agjencinë Kavajë	31,000,000	
30	Rikonstruksion, zgjerim në rrjetin 20 kV në fiderat e nënstationit Sallmone, si dhe ndërtim rrjeti TU me përcjellës ABC	175,000,000	
31	Rikonstruksion i kabinave dhe ndërtim rrjeti TU në fiderat e nënstationit 35/10 kV Manëz	65,895,359	
32	Rikonstruksion i kabinave dhe ndërtim rrjeti TU në fiderat e nënstationit 35/6 kV Rreth	50,000,000	
33	Zgjatim i fiderit 20 kV nr. 3, Sallmone në drejtim të Xhafzotaj	145,000,000	



34	Kthimi në linjë kabllore nëntokësore 20 kV i fiderit 44 nënstationi Shkozet 110/20 kV për në zonën e Vilës së Zogut	10,327,651	
35	Zhvillimi i fiderave 20 kV të nënstationit Selitë	270,000,000	
36	Ndërtimi i rrjetit shpërndarës TM/TU i fiderit 336,20 kV (segmenti nga pika A deri te kab. e Izraelit 2), nënstationi Selitë	110,000,000	
37	Rikonstruksion i kabinave 6 kV dhe kthimi në 20 kV, linja kabllore TM dhe kabina të reja tip <i>Box</i> , 20 kV	140,000,000	
38	Zhvillimi i rrjetit 20 kV TM/TU për fiderat E7, E8 dhe E9, nënstationi Farkë 110/20/10 kV	137,025,443	
39	Zhvillimi i rrjetit 20 kV TM/TU për fiderat C16, C17 dhe C18, nënstationi Traktora 110/20/6 kV	108,422,711	
40	Ndërtim rrjeti shpërndarës TM/TU, fideri 355 20 kV, nënstationi rajonal 220/110/20 kV	160,000,000	
41	Ndërtimi i fiderit të ri Fabrika e Tullave 2, nënstationi Lezhë	66,840,448	
42	Ndërtim i fiderit 340, 20 kV dhe lidhja ne unazë me Fiderin 333 20 kV, nënstationi Selitë	33,199,265	
43	Rikonstruksioni i një segmenti të Fiderit 323,20 kV, Selitë (kthimi nga rrjet ajror në kabllor)	40,000,000	
44	Ndërtimi i fiderit 356, 20 kV, nënstationi rajonal	54,000,000	
45	Projektim-zbatim i monitorimit të plotë të tunelit të kabllorëve në nënstationin qendër	48,000,000	
46	Studimi, analiza e furnizimit të pandërprerë me energji elektrike dhe rritja e shkallës së sigurisë së rrjetit të Tiranës	65,000,000	
47	Studimi i zhvillimit të rrjetit inxhinierik për furnizimin me energji elektrike në qendër të Tiranës, në përputhje me zhvillimin urban të Bashkisë Tiranë	55,000,000	
48	Rikonfigurimi i rrjetit 20 kV i zonës së Zogut të Zi, nënstationi qendër dhe rajonal	40,000,000	
49	Rikonstruksion i kanaleve kabllore të nënstationeve elektrike (1500 ml)	35,000,000	
50	Rikonstruksioni i fiderave të linjave 20 kV (Fideri 29 dhe 30) në zonën e Bregut të Lumit	17,000,000	
51	Rikonstruksion I I rrjetit kabllor 6 kV në nivelin 20 kV për objektet qeveritare	40,000,000	
52	Ndërtim kabine të re shtyllore, LTM, LTU me ABC - "Kab. Zarranik 2"	1,878,146	
53	Spostimi i kabinës së Ministrisë së Rendit (pajisje makineri tev. kabinës+montimi)	11,998,000	
54	Spostimi i kabinës së Ministrisë së Rendit (punimet civile + linja TM, TU dhe lidhja me rrjetin ekzistues)	10,791,962	
55	Rrjeti TM 20 kV, fideri E-10 nga nënstationi Farkë 110/20/10 kV	38,363,000	
56	Rikonstruksion në rrjetin TM - TU në fiderat F1-F2 Shijak	42,730,000	
57	Rikonstruksion në rrjetin TM - TU në fiderat F3 -F4 si dhe fiderat 6 kV Shijak	17,270,000	
58	Ndërtim i unazës së fiderave Shkozet F 50-51	293,000,000	
59	Ndërtim i unazës së fiderave Shkozet F 52-53	265,701,682	
60	Rrjeti elektrik shpërndarës i nënstationit 110/20 kV Golem, Fideri F1 dhe F2, Durrës	171,057,354	
61	Zhvillimi i rrjetit 20 kV TM/TU në qytetin e Fushë-Krujës	189,172,154	
62	Zgjatim i fiderit 55S me linjë kabllore nëntokësore, kabina të reja dhe rrjet TU të ri	34,800,000	
63	Zgjerimi i rrjetit 20 kV nga F.53 nënstationi Shkozet, kabina të reja dhe rrjet TU, për zonën Kantina e Verës, Tuneli i Trenit-Laboratori i Rrashbullit	100,650,000	
64	Kalimi i linjës ajrore 20 kV të fiderit 42-44, nënstationi Shkozet, në linjë kabllore nëntokësore, segmenti Shkozet – Durrës	42,956,000	
65	Zgjatimi i fiderit 20 kV, nr. 11, nga pika e shpërndarjes nënstationi Rreth në drejtim të Romanatit, ndërtimi i kabinave dhe rrjet TU i ri	188,380,000	
66	Zgjatimi i Fiderit 20 kV, nr. 10, nga pika e shpërndarjes nënstationi Rreth dhe bërja e tij unazë me fiderin 3, nënstationi Sallmone. Ndërtimi i kabinave dhe rrjet TU i ri	115,845,000	
67	Rikonstruksion kabinash dhe rrjet TU ABC në Këlcyrë	55,000,000	



68	Rikonstruksion kabinash dhe rrjet TU ABC, fideri Kardhiq, Gjirokastrë	45,000,000	
69	Rikonstruksion kabinash dhe rrjet TU ABC, Dropull i Poshtëm, Gjirokastrë	45,000,000	
70	Rikonstruksion kabinash dhe rrjet TU ABC në qytetin e Tepelenës	35,000,000	
71	Rikonstruksion kabinash dhe rrjet TU ABC në qytetin e Memeliajt	35,000,000	
72	Zhvillimi i rrjetit shpërndarës 20 kV nga nënstacioni 110/20 kV Fier F1, F2, F8 dhe F9	326,674,353	
73	Rrjeti shpërndarës 20 kV nga nënstacioni 110/20 kV, pjesa e tretë	150,000,000	
74	Rrjeti shpërndarës 20 kV, TU dhe kabina nga nënstacioni nr. 2, Drenovë	38,397,979	
75	Ndërtim rrjeti TM, 20 kV, si dhe kabinave dhe rrjet TU me ABC në zonën Shëllq, Fier, nënstacioni Fier	50,000,000	
76	Projektit të rikualifikimit të zonës urbane pranë qendrës së qytetit të Vlorës	30,000,000	
77	Sistemim rrjeti shpërndarës 20 kV dhe 6 kV për Lungomaren	40,000,000	
78	Fideri nr. 6 VJ6, nënstacioni Vlora 2; 110/20 kV	45,574,616	
79	Rikonstruksion kabine dhe rrjet TU me kablo ABC "Sera 2", Fideri J5 nënstacioni 110/35/20/3 kV	1,388,074	
80	Rikonstruksion TM/TU i kabinës Xhenjo, Orikum, Vlorë	7,000,000	
81	Ndërtimi i rrjetit të ri elektrik në autostradën Laç – Mamurras	116,393,261	
82	Rikonstruksion rrjet TM 6 kV, Fideri 5, Fan, nënstacioni Reps	28,538,630	
83	Ndërtim kabinash TM/TU, rikonstruksion linja TU me përcjellës ABC Agjencia Burrel, Mirditë (kabina shtyllore Bardhaj nr. 2, kabina shtyllore Shkallë nr. 3, kabina shtyllore Unjatë nr. 2, Kabina shtyllore Bel nr. 3, kabina shtyllore Zall Bershë nr. 2, Kabina shtyllore Batër e Vogël nr. 3, kabina shtyllore Blat)	10,000,000	
84	Rikonstruksion rrjeti TM ajror, fideri nr. 5, nënstacioni Reps 110/6 kV	29,000,000	
85	Rikonstruksion rrjeti TM ajror, fideri nr. 3, nënstacioni Kurbnesh 110/6 kV	11,000,000	
86	Rikonstruksion rrjeti TM ajror, fideri hekurudha nënstacioni Laç 1, 110/6 kV	12,700,000	
87	Ndërtim i kabinës elektrike Gjanë, fideri 3, nënstacioni Rexhepaj	1,265,689	
88	Ndërtim i linjës TM, fideri 3, nënstacioni Rexhepaj (drejtimi Bushtricë)	3,355,153	
89	Rikonstruksion rrjeti ajror TM Fajanca–Voskopojë	10,005,045	
90	Rikonstruksion rrjeti TU me kablo ABC në zonën e Peqinit (lista analirike, mars 2017)	65,814,644	
91	Zhvillimi i rrjetit shpërndarës 20 kV TM/TU në Agjencinë e Elbasanit	275,000,000	
<b>VI</b>	<b>Ndërtim/rikonstruksion kabinash elektrike</b>	<b>1,163,205,727</b>	<b>848,304,000</b>
1	Rikonstruksion ndërtimor i kabinave elektrike në Tiranë	1,364,149	
2	Rikonstruksion rrjeti TM 20 kV (8 lote)	150,000,000	
3	Rikonstruksion i kabinave elektrike (ndërtimor dhe elektrik)	255,000,000	
4	Rikonstruksion ndërtimor i kabinave elektrike Durrës	32,712,417	
5	Rikonstruksion i kabinave elektrike me çela RMU të motorizuara në Agjencinë Durrës	67,000,000	
6	Rikonstruksion i kabinës elektrike me çela RMU të motorizuara në F. 45, nënstacioni Shkozë	30,000,000	
7	Rikonstruksioni i magazinave M1.M2; M3 për ndërtesën e zyrave të rajonit Durrës	50,475,000	
8	Shtesë kontrate për ndërtesën e OSHEE-së	85,888,727	
9	F.V. ashensor elektrik	6,000,000	
10	F.V. motor gjenerator	8,000,000	
11	Mobilimi i zyrave (godina e re OSHEE)	190,000,000	
12	Ndërtimi i zyrave të rajonit Durrës	100,000,000	
13	Rikonstruksioni i zyrave të njësisë Kavajë	3,000,000	
14	Rikonstruksioni i zyrave, rajoni Korçë	65,000,000	
15	Rikonstruksioni i zyrave të rajonit Vlorë	40,000,000	
16	Rikonstruksioni i zyrave dhe magazinave në rajonin Shkodër	65,000,000	
17	Rikonstruksion i zyrave dhe magazinave në Drejtorinë Rajonale Tiranë	13,765,434	
18	Blerje transformatorësh		848,304,000



<b>VII</b>	<b>INVESTIMET PRIORITARE (RRJET TU - ABC LINES)</b>	<b>775,937,126</b>	<b>0</b>
1	Rikonstruksion rrjetit TU të Agjencisë Durrës	30,000,000	
2	Zhvillim rrjeti TM në zonën urbane Fushë-Mbret, lagjja “Skënderbej”	12,000,000	
3	Furnizim me burim të dytë me TU i Ambasadës Kineze	1,565,061	
4	Rikonstruksioni I I linjave TU me ABC I I fiderit 2 IBE+E5	48,000,000	
5	Ndërtim rrjeti TU me përcjellës Al me vetëmbajtje të tipit ABC, kabina 1/14	20,842,000	
6	Ndërtim Rrjeti TU me përcjellës Al me vetëmbajtje të tipit ABC, kabina Germej 2	27,000,000	
7	Rikonstruksion rrjeti TM-TU në agjencinë Fushë-Krujë	190,300,000	
8	Linjë TU me përcjellës ABC kabina Bulgarec 1, 2, 3, 4 dhe kabina “Stacioni pompave Bulgarec” dhe rikonstruksion i kabinave	10,000,000	
9	Linjë TU me përcjellës ABC kabina në qytetin Maliq	10,000,000	
10	Rikonstruksion rrjet TU me kablo ABC me vetëmbajtje, fshati Pojan	13,884,329	
11	Rikonstruksion rrjet TU me kablo ABC me vetëmbajtje, qyteti Bilisht	10,746,637	
12	Ndërtimi i rrjetit TU me kablo ABC, kabinave të fiderit nr. 2, nënstationi 35/10, Ciflik, Berat	78,097,883	
13	Rrjeti TU ABC fideri nr. 6, nënstationi plastmase 110/20 kV	23,875,818	
14	Projekti “Ndërtim rrjeti TU me kablo me vetëmbajtje ABC për kabinat: Kuman 1, 2, 3, 4, 5, 6; Luar 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 10, 13; Jagodinë 2; Kurjan 5; Vidhisht 1, 2, 3, 4, 6; Marinëz 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7; Roskovec Oficina”, fideri 2 FK, nënstationi Jagodinë	88,020,476	
15	Projekti “Ndërtim rrjeti TU me kablo me vetëmbajtje ABC për kabinat: Sturm 8, Sturm 3, Sturm 4, Sturm 7, Sturm 11, Velmish 8, Velmish 3”, fideri Strum, nënstationi Matkë	13,480,187	
16	Zhvillim rrjeti TM/TU në zonën Tragjas	16,000,000	
17	Ndërtim i fiderit të ri nënstationi Mifol, për zonën Novoselë-Akerni-Bishan, si dhe rrjet TU me ABC	39,922,221	
18	Rikonstruksioni i rrjetit TU 0.4 kV Burrel (lista analitike)	51,787,807	
19	Ndërtim rrjeti TU 0.4 kV (lista analitike mars 2017)	65,946,745	
20	Rikonstruksion linja TU, njësia Peshkopi (kabina Tomini, kabina Pollozhan, kabina Pilafe, kabina Kuke, Kastriot, kabina Sohodoll 1, kabina Sohodoll 2)	24,467,962	
<b>VIII</b>	<b>TEKNOLOGJI MONITORIMI</b>	<b>500,732,000</b>	<b>179,013,000</b>
1	Instalimi, montimi i sistemit të kontrollit të rrjetit të Vlorës (faza e parë)	286,700,000	
2	Pajisje dhe programe për sistemin e projektimit	5,000,000	
3	Investimi për sistemin SCADA	100,000,000	
4	Ngritja e platformës së leximit <i>online</i>	109,032,000	
5	Investime të sistemin <i>Billing</i>		179,013,000
<b>IX</b>	<b>INVESTIME NË MATJE</b>	<b>330,000,000</b>	<b>904,200,000</b>
1	Blerje boksesh individuale	150,000,000	
2	Platforma e shitjes së energjisë	30,000,000	
3	Investimi në matjen e bilancit në tensionin e ulët të kabinave dhe MDM	150,000,000	
4	Blerje matësish elektrikë		904,200,000
<b>X</b>	<b>INVESTIME NË TEKNOLOGJINË E INFORMACIONIT</b>	<b>439,000,000</b>	
	Rritja e kapaciteteve të përpunimit të të dhënave dhe shtimi i teknologjisë së virtualizimit	60,000,000	
	<i>Upgrade</i> në infrastrukturën aktuale <i>Data Center</i> në <i>Primary Site</i> dhe <i>BCC</i>	90,000,000	
	Sistem fonie, mikrofonat statikë dhe të lëvizshëm, <i>video wall</i> për sallat e mbledhjeve dhe për evente të ndryshme	40,000,000	
	Blerje pajisjesh kompjuterike: <i>Desktop; laptop; ploter</i> për printimin e projekteve A0+etc.	26,000,000	
	Investim në sistemin e leximit të matësve	63,000,000	
	<i>Upgrade</i> në sistemin GIS/asete për: - modulën e menaxhimit të riparimit të defekteve në rrjetin energjetik; - integrimi me sistemin e <i>Work Force Management</i> ; - integrimi në hartë i sistemit/të dhënave të leximeve të konsumit të abonentëve	40,000,000	





	Sistemi për menaxhimin e proceseve të punës në terren, duke përfshirë dhe bazën materiale sipas procedurave të brendshme (ndërlidhje <i>online</i> me KNK-në)	58,000,000	
	Blerje <i>Videwall</i> për godinën e OSHEE sh.a.	55,000,000	
	Blerje UPS	6,500,000	
XI	Vlera 10% që do të paguhet nga OSHEE sh.a. për investimet Bankës Botërore	214,000,000	
XII	Kostoja lokale për investimet e Bankës Botërore	747,856,573	
	<b>TOTALI, VITI 2017</b>	<b>12,555,266,570</b>	<b>3,467,648,000</b>
			<b>16,022,914,570</b>

## VENDIM

Nr. 210, datë 28.12.2017

### PËR MIRATIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT TË TRANSMETIMIT TË ENERGISË ELEKTRIKE NGA OST SHA PËR VITIN 2018

Në mbështetje të neneve 16; 19, germa “c/i”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 22 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve, në lidhje me kërkesën e OST sh.a. për miratimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike, për periudhën 1 janar 2018 – 31 dhjetor 2018,

konstatoi se:

- Bordi e ERE-s, me vendimin nr. 202, datë 5.12.2017, vendosi mbi fillimin e procedurës për miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a. për vitin 2018.

- ERE, me shkresën nr. 758/2 prot., datë

7.12.2017, pas analizës së kryer këtij aplikimi, i kërkoi informacion shtesë OST sh.a., në mënyrë që kompania të argumentonte më gjerë këtë aplikim dhe që ERE të ishte sa më e drejtë në llogaritjen e kostove që i përkasin OST sh.a. në ushtrimin e aktivitetit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2018.

- OST sh.a. iu përgjigj kërkesave për informacion të ERE-s me anë të shkresës nr. 7035, prot., datë 15.12.2017. Pas analizës së përgjigjeve të OST sh.a. u zhvillua një seancë teknike në datën 26.12.2017, me përfaqësues të kompanisë dhe më tej u ra dakord që të

dërgoheshin në ERE sqarime të mëtejshme për paqartësitë e lindura në lidhje me analizën e kryer të aplikimit në vetvete dhe, gjithashtu, të përgjigjeve të dërguara nga OST sh.a., të pyetjeve të dërguara nga ERE me anë të shkresave të lartpërmendura.

- Në llogaritjen e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2018 OST sh.a. ka llogaritur kostot totale që ajo do të përballojë gjatë gjithë vitit 2018 dhe respektivisht kostot e kapitalit, kostot operative të paraqitura në 4 skenarë të ndryshëm të mundshëm, në varësi të supozimeve për pranimin e komponentëve të ndryshëm, që, për rrjedhojë, rezultojnë në nivele të ndryshme të tarifës mesatare të transmetimit për vitin 2018, duke e lënë në gjykimin e ERE-s pranimin e njërit apo tjetrit komponent apo skenar.

- OST sh.a., në përputhje me vendimin nr. 135, datë 6.9.2017, “Mbi miratimin e rregullores së procedurave të paraqitjes dhe të miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike,” të paraqesë planin e investimeve të përditësuar për vitin 2018, i cili do të jetë objekt i vendimmarrjes së bordit, sipas rregullores së procedurave të paraqitjes dhe të miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike.

- Nga aplikimi vërehet se shoqëria OST sh.a., gjatë vitit 2017, parashikon të shpenzojë 1,165 milionë lekë për prokurimin e humbjeve në rrjet, humbje e cila është vlerësuar me rreth 169 milionë kwh. Nga shoqëria OST sh.a. parashikohet që kjo sasi energjie të blihet në treg dhe parashikohet të blihet me një çmim mesatar prej 50 euro/mwh, bazuar në të dhënat e HUPX-së.



- OST sh.a., në aplikimin e saj për tarifë parashikon që të shpenzojë rreth 500 milionë lekë për pagesa CBT-je për vitin 2017, shumë e cila varet nga marrëdhëniet e shkëmbimit të energjisë me shtetet e tjera. Për llogaritjen e një shpenzimi të tillë OST sh.a. është mbështetur edhe në trendin disavjeçar të këtyre lloj pagesave, duke marrë në konsideratë dhe faktin se energjinë për mbulimin e humbjeve do ta prokurojë në treg të parregulluar dhe se rritja e çmimit të prokurimit të humbjeve do të influencojë direkt në rritjen e pagesave për CBT-në. I qëndrojmë vlerësimin të shoqërisë bazuar në argumentimin e paraqitur nga OST sh.a.

- Në aplikimin për tarifën e transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2018, OST sh.a. ka parashikuar një sërë shpenzimesh që lidhen me prokurimin e kapacitetit rregullues dhe atij rezervë për shërbimin e balancimit. Në total këto shpenzime, ku përfshihen kapacitetet rezervë të rregullimit dhe ridispeçerimi kapin shifrën prej 1,233 milionë lekësh, kundrejt 100 milionë lekëve shpenzuar për periudhat paraardhëse.

- Vlera neto e aseteve pasi janë marrë në konsideratë të dhënat faktike të bilancit 2016 arrin në 33,363, realizimi i pritshëm për vitin 2017, sipas raportimeve të fundit me 36,487 milionë lekë krahasuar me 48,747 të cilën e propozon OST sh.a. për vitin 2018.

- Në aplikim theksohet se volumi i transaksioneve të energjisë dhe, si rrjedhojë edhe i kërkesës për kapacitete transmetuese në interkoneksion, nuk është proporcional përgjatë gjithë muajve të vitit dhe se merren parasysh risitë dhe paqartësitë e alokimit të kapaciteteve në interkoneksione nga zyra përkatëse rajonale, CAO në Podgoricë, në parashikimin e të ardhurave që OST sh.a. mund të sigurojë në ankandet e alokimit të kapacitetit në interkoneksion gjatë gjithë vitit 2018, të cilat parashikojnë të jenë rreth 8 milionë euro ose 1,100 milionë lekë dhe që do të sigurohen nga pjesëmarrësit e tregut.

- Nga të dhënat faktike të pasqyrave financiare të viteve 2015, 2016 dhe atyre të pritshme për vitin 2017 rezulton se tarifat faktike respektive të transmetimit për këto vite janë 0,48 lekë/kwh, 0,55 lekë/kwh dhe 0,65 lekë/kwh. Bazuar në këto nivele tarifash është llogaritur efekti në të ardhurat e shoqërisë, duke u reflektuar si

axhustim i periudhave të kaluara në llogaritjen e tarifës për vitin 2018 në zbritje për vlerat 1,172 milionë lekë, 637 milionë lekë dhe 31 milionë lekë, si të ardhura të tepërta, përkatësisht për vitet 2015, 2016 dhe 2017, kundrejt tarifës së miratuar prej 0,65 lekë/kwh për këto vite.

- Nga sa shpjeguar dhe evidentuar në tabelë si më sipër, rezultatja e të gjithë komponentëve të të ardhurave të kërkuara për aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2018 llogaritet në një vlerë totale prej 5,391 milionë lekësh dhe tarifa mesatare e transmetimit e llogaritur për sasinë (7,231 gwh) që parashikohet të livrohët në rrjetin e transmetimit rezulton 0.75 lekë/kwh.

- Duke qenë se procedura për shqyrtimin e aplikimit dhe analiza e informacionit shtesë dhe e sqarimeve përkatëse, kërkon kohën e saj, ndërkohë që aplikimi nga ana e OST sh.a. është tejet i vonuar, në lidhje me OPEX dhe CAPEX në tërësi, ERE rezervon të drejtën e rishikimit të këtyre shpenzimeve, në periudhat e ardhshme kundrejt vlerave reale të tyre.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a., për vitin 2018, të jetë 0,75 lekë/kwh.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë të interesuarit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit Ahmeti**



## VENDIM

Nr. 211, datë 28.12.2017

### **MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË OSHEE SHA PËR TARIFAT E SHËRBIMIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, SIPAS NIVELIT TË TENSIONIT DHE LËNIEN NË FUQI TË ÇMIMEVE ME PAKICË PËR KLIENTËT QË SHËRBEHEN NGA FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL PËR VITIN 2018**

Në mbështetje të neneve 16; 19, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 19, pika 1, germa “c” dhe nenit 22, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin të bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, si dhe “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të shpërndarjes së energjisë elektrike”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve në lidhje me kërkesën e OSHEE sh.a. për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të OSHEE sh.a., për tarifën dhe shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike sipas nivelit të tensionit dhe lënien në fuqi të çmimeve me pakicë për klientët që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal për vitin 2018,

konstatoi se:

- Në respekt të nenit 21 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, afati maksimal i paraqitjes së aplikimit për tarifë duhet të ishte data 1 shtator 2017, në mënyrë që të mundësohej vendimmarrja brenda muajit dhjetor të vitit 2017.

- Aplikimit i mungon analiza e detajuar dhe argumentet përkatëse për të gjitha shpenzimet operative për vitin ushtrimor të mbyllur dhe të audituar (2016) dhe e shpenzimeve të pritshme për vitin 2017. Gjithashtu, analiza e realizimit të të ardhurave të kërkuara për vitet 2015–2017 duhet të krahasohej me të ardhurat e miratuara dhe diferencat të reflekttoheshin në të ardhurat e kërkuara për vitin 2018. Kjo në zbatim të pikës 5, të vendimit nr. 190, datë 22.12.2016, të bordit të ERE-s, e cila përcakton se: Përditësimi dhe kompensimi i të gjitha efekteve të mundshme

financiare për të licencuarit për periudhën 2015 dhe vitin 2016 do të bëhet në periudhën pasardhëse sipas përcaktimeve të nenit 20, germa “c”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

- Aplikimi nuk plotëson kërkesën e nenit 72, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, për ndarjen e aktiviteteve që vendos si afat përfundimtar datën 31.12.2017.

- Aplikimi nuk përmbush kërkesën e pikës 1, të nenit 109, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, për afatet e daljes graduale në treg të liberalizuar të klientëve sipas niveleve të tensionit.

- Nuk është paraqitur në aplikim një analizë e detajuar dhe e argumentuar e kostove operative për periudhën e ardhshme 2018, konform dispozitave 7.2 e 7.3 të “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të shpërndarjes së energjisë elektrike”.

- Lidhur me bilancin energjetik për vitin 2018, konstatohet se nuk ka rakordim me parashikimet e bëra nga OST sh.a. për të njëjtën periudhë.

- Paraqitja me vonesë e planit të investimeve për vitin 2018 në ERE, i cili do të jetë objekt i vendimmarrjes së bordit sipas “Rregullores së procedurave të paraqitjes dhe të miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike”, në përputhje me vendimin nr. 135, datë 6.9.2017.

- Nuk janë paraqitur marrëveshjet dypalëshe midis KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 519, datë 13.7.2016, “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”.

- Mungesa e argumentimeve përkatëse në lidhje me llogaritjen e koeficientëve të propozuar të alokimit, bazuar në strukturën e shitjes, si dhe humbjet e energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes, të cilët janë përdorur për shpërndarjen e kostove në nivele tensioni.

- Përlllogaritja e tarifës në zbatim të ligjeve në fuqi ka marrë parasysh gjendjen e vështirë financiare që po kalon shoqëria. Në përlllogaritjen e të ardhurave të kërkuara janë llogaritur edhe kostot e shkaktuara si pasojë e mosrealizimit të furnizimit nga KESH sh.a. gjatë vitit 2017, për shkak të thatësisë së zgjatur.

- Çmimet për energjinë e blerë nga KESH dhe HEC-et private në kuadrin e detyrimit të shërbimit universal për vitin 2018 parashikohet të jenë



respektivisht 1.5 lekë/kwh dhe 8.5 lekë/kwh.

- OSHEE sh.a. i llogarit shpenzimet për mbulimin e humbjeve të energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2018, si diferencë e shpenzimeve për prokurimin e të gjithë sasisë së energjisë elektrike të livruar në rrjetin e shpërndarjes, me shpenzimet për blerjen e energjisë së nevojshme për shërbimin e furnizimit universal, në të cilin përfshin vetëm 3,413 kwh energji elektrike të blerë nga KESH sh.a. Shpenzimi për mbulimin e humbjeve parashikohet të jetë në shumën 8,905 milionë lekë.

OSHEE sh.a., duke arsyetuar se “meqenëse tarifa mesatare e përlllogaritur sa më lart për vitin 2018 është thujse e njëjtë me atë të vitit 2015, duke u mbështetur në përvojën pozitive të arritjeve të periudhës 2015–2017”, propozon që:

- Tarifa e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike të jetë ajo e miratuar me vendimin nr. 147, datë 25.12.2014, të bordit të ERE-s.

- Çmimi mesatar i shitjes së energjisë elektrike, si dhe çmimet e detajuara për kategoritë e klientëve sipas niveleve të tensionit të jenë ato të miratuara me vendimin nr. 148, datë 25.12.2014, të bordit të ERE-s.

- Për vitin 2017, në lidhje me çmimin e shitjes së energjisë nga prodhuesit me përparësi konsiderohet i pandryshuar nga ai i përcaktuar për vitin 2016, siç parashikon neni 22, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen

e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”.

- Për vitin 2018 çmimi vjetor i shitjes së energjisë elektrike në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 687, datë 22.11.2017, “Metodologjia për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”, do të përcaktohet mbas publikimit të raportit vjetor për tregun e ditës në avancë për vitin 2017, sipas publikimit në faqen zyrtare të bursës hungareze.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të OSHEE sh.a. për përcaktimin e tarifave të shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike për nivele tensioni për vitin 2018.

2. Lënien në fuqi të vendimit nr. 13, datë 16.2.2016, “Mbi tarifën fikse të energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet për vitin 2016 deri më 31 dhjetor 2017.

3. Lënien në fuqi të pikës “1”, të vendimit nr. 52, datë 6.4.2017, “Mbi lënien në fuqi të vendimit nr. 190, datë 22.12.2016, të bordit të ERE-s”, sipas tabelës më poshtë:



TIPII AKTIVITETIT	NR. IVENDIMIT	TARIFAT E MIRATUARA
Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV	Nr. 52, Datë 06.04.2017	1.5 Lekë/Kwh
Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 20 kV	Nr. 52, Datë 06.04.2017	3.9 Lekë/Kwh
Tarifa mesatare e shërbimit të shpërndarjes	Nr. 52, Datë 06.04.2017	4.79 Lekë/Kwh
Çmimi I shitjes për Klientët në 20 kV *	Nr. 52, Datë 06.04.2017	11 Lekë/Kwh Në Pik 12.65 Lekë/Kwh
Çmimi I shitjes për Klientët në 10/6 kV *	Nr. 52, Datë 06.04.2017	11 Lekë/Kwh Në Pik 12.65 Lekë/Kwh
* Miratim I përkohshëm për klientët që nuk arrijnë të sigurojnë furnizues në treg për shkak të pamundësisë objektive të operatorëve të sistemit në përputhje me VKM nr. 449, datë 15.06.2016, furnizimi si mundësi e fundit i këtyre klientëve kryhet në të njëjtat kushte me shërbimin universal të furnizimit me çmimet si më lart		
Çmimi I shitjes për Konsumatorët e lidhur në TM dhe me matës në TU	Nr. 52, Datë 06.04.2017	12.4 Lekë/Kwh Në Pik 14.3 Lekë/Kwh
Çmimet e shitjes me pakicë për klientët fundor	Nr. 52, Datë 06.04.2017	*Çmimet paraqiten në tabelën më poshtë
<b>TARIFAT E SHËRBIMEVE TË SHITJES ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR KLIENTËT FUNDOR</b>		
Niveli I tensionit	Çmimi (Lekë/kWh)	Çmimi pik (Lekë/kWh)
Furra buke dhe prodhim mielli në 10/6 kV	7.1	8.17
Klientë në 0.4 kV	14	16.1
Furra buke dhe prodhim mielli në 0.4 kV	7.6	8.74
Familjarë	9.5	
Tarifa për konsumin e energjisë elektrike në ambientet e përbashkëta (ndricim shkalle, pompe, ashensor)	9.5	
Tarifë fikse e shërbimit për leximin "zero" (Lekë/Muaj)	200	
* Çmimi i energjisë reaktive është sa 15% e çmimit të energjisë aktive		
* Orari pik gjatë të cilit do të aplikohet tarifa për energjinë e konsumuar në pik është :		
Për periudhën 1 Nëntor - 31 Mars nga ora 18:00 deri në 22:00		
Për periudhën 1 Prill - 31 Tetor nga ora 19:00 deri në 23:00		

4. Lënien në fuqi të vendimit nr. 53, datë 6.4.2016, "Mbi çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi universal për kategorinë objekte kultiv/bashkësi fetare, datë 6.4.2017".

5. OSHEE sh.a., përveç shlyerjes së detyrimeve korente, të kryejë edhe pagesat ndaj KESH sh.a. dhe OST sh.a. nga detyrimet e prapambetura për qëllime të pagesave të kredive nga OST sh.a. dhe KESH sh.a.

6. Rishikimin e të ardhurave të kërkuara të furnizuesit të shërbimit universal, në periudhat pasardhëse, për shkak të rishikimit të tarifës së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike sipas niveleve të tensionit.

7. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë të interesuarit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohej në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit Ahmeti**

**VENDIM****Nr. 212, datë 28.12.2017****MBI MIRATIMIN E PLANIT TË  
INVESTIMEVE PËR VITIN 2017 DHE  
ATË DHJETËVJEÇAR, 2015–2025, TË  
ZHVILLIMIT TË RRJETIT TË  
TRANSMETIMIT TË SHOQËRISË  
OST SHA**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 20, gerrat “a” dhe “e”; nenit 60, pikat 1; 4 dhe 5; të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; neneve 6; 7; 8; 10; 11; 12 dhe 13 të rregullores “Për procedurat e paraqitjes dhe të miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 62, datë 15.9.2009, si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016 të bordit të ERE-s; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2017, mbasi shqyrtoi relacionin mbi miratimin e planit të investimeve për vitin 2017 dhe atë dhjetëvjeçar, 2015–2025, të zhvillimit të rrjetit të transmetimit të shoqërisë OST sh.a., të përgatitur nga drejtoritë teknike,

konstatoi se:

- ERE, me shkresat nr. 774 prot., datë 3.11.2016 dhe nr. 275 prot., datë 30.3.2017, i ka kërkuar shoqërisë OST sh.a. paraqitjen për miratim të planit të investimeve për vitin 2017.

- OST sh.a., me anë të shkresën nr. 1771/2 prot., datë 29.5.2017, ka paraqitur në ERE planin e investimeve për vitin 2017.

- Në vijim, ERE, me shkresën nr. 584 prot., datë 30.8.2017, i është drejtuar OST sh.a. për paraqitjen për miratim të planit dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit të transmetimit.

- OST sh.a., me shkresën nr. 4677/1 prot., datë 6.9.2017, ka dërguar pranë ERE-s për miratim planin dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit të transmetimit.

- Aplikimi plotëson kryesisht kushtet e përcaktuara në rregulloren “Për procedurat e paraqitjes dhe të miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 62, datë 15.9.2009.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të miratojë planin e investimeve të OST sh.a. për vitin 2017, në vlerën 2,183,846,979 lekë.

2. Të miratojë planin dhjetëvjeçar, 2015–2025, të zhvillimit të rrjetit të transmetimit në vlerën 285,437,528 euro.

3. OST sh.a. duhet të përditësojë çdo vit planin dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit, sipas kriterëve të përcaktuara në “Rregulloren e procedurave të paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 135, datë 6.9.2017.

4. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorëve të njoftojë OST sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendrike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit Ahmeti**



INVESTIMET E PARASHIKUARA NGA OST SHA PËR VITIN 2017 (LEKË)		
1	Zgjerimi i nënstacionit Koman me një autotransformator 400/220 kV	480,557,640
2	Rikonstruksioni i linjës Laç 1-Laç 2 dhe impiantit 110 kV të nënstacioneve Laç 2	194,382,185
3	Furnizim, vendosje e një AT 1Z0 MVA 220/110/35 kV në Elbasan 1	193,818,990
4	Blerja dhe instalimi i analizatorëve të vajit dhe përcaktimit të gjendjes së izolacionit për transformatorët 10 sete DGA	193,480,000
5	Rikonstruksioni impiantit 110 kVh e nënstacionit Jaqodine	180,000,000
6	Rikonstruksioni i impiantit 110 kV të nënstacionit Rubik	140,000,000
7	Rritja e kapaciteteve të transmetimit të OPGW STXK	130,000,000
8	Monitorimi i izolatorëve kalimtarë dhe shkarkimeve parciale	85,000,000
9	Transferimi i QME-së, ndërfaqja me platformën e tregut dhe furnizimi dhe vendosja e dy trakteve të matjes, nënstacioni Kurbnesh, Shutri	80,000,000
10	Furnizim, vendosje e dy çelësave 220 kV në Koman	65,000,000
11	Përfundimi i punimeve për vënien në punë të pjesës kabllore të linjës 110 kV, Tirana 2-Selitë	65,000,000
12	Pajisje primare për mirëmbajtjen e nënstacioneve	50,000,000
13	Blerje të pajisjeve sekondare për zyrën e mbrojtjes (Rele)	50,000,000
14	Implementimi i sistemit të analizimit të rrjetit nëpërmjet PMU ( <i>Phasor Measuring Unit</i> )	40,000,000
15	Blerje <i>Server-a</i> , <i>Storage</i> , pajisje <i>Network</i> për <i>backup site</i> dhe <i>disaster recovery</i> dhe migrim i sistemeve ekzistuese në <i>Disaster Recovery</i>	40,000,000
16	Licencë të produkteve <i>Microsoft</i>	37,377,428
17	Zhvillimi dhe instalimi i një sistemi për klasifikimin, mbrojtjen dhe parandalimin e rrjedhjes së informacionit elektronik të OST sh.a.	23,000,000
18	Aparate testuese për TR rrymë dhe tension	20,000,000
19	Përmirësimi i infrastrukturës së <i>Data Network</i> , <i>Sistem</i> , akses kontrolli për hyrje-daljet së bashku me një <i>Software</i> për përlogaritjen automatike të pagave	15,000,000
20	Zgjerim i sistemit SCADA mbi kontroll-monitorimin, duke ridimensionuar kanalet e komunikimit IEC 60870-5-104	14,662,500
21	Blerje programi kompjuterik për krijimin, mirëmbajtjen, analizën, konvertimin dhe shkëmbimin e modeleve të rrjetave të transmetimit në formatet që përdoren nga PSSE-ja dhe formatin e kërkuar nga ENTSO-E: CIM Profile, CGMES	13,000,000
22	Blerje kompjuter, laptop dhe pajisje printimi multifunkionale	11,868,236
23	Mbikëqyrja e punimeve për objektet e reja	10,000,000
24	Rinovimi i suportit dhe <i>upgrade-im</i> i sistemit të monitorimit të shtyllave të transmetimit	10,000,000
25	Blerje e standardeve IEC	7,000,000
26	Implementimi i menaxhimit të dokumentacionit në mënyrë elektronike	6,000,000
27	Blerje ploter + fotokopje + skaner	5,000,000
28	Ndërtimi i një sistemi me bazë të dhënash për menaxhimin e parametrave të sistemit energjetik	5,000,000
29	Menaxhimi i problemeve të sistemeve të operimit nëpërmjet një sistemi <i>Issue tracer</i>	5,000,000
30	Ndërtim bazamenti për autotransformatorin 120 MVA në nënstacionin Elbasan 1	5,000,000
31	Rikonstruksioni i godinës së nënstacionit Koplik	3,000,000
32	Blerje pajisjesh specifike për mirëmbajtjen e sistemeve të kontroll-monitorimit	3,000,000
33	<i>Upgrade-im</i> /Përditësim i sistemit të monitorimit të automjeteve të OST sh.a.	2,700,000
	<b>TOTAL</b>	<b>2,183,846,979</b>



## PLANI DHJETËVJEÇAR, 2015–2025, I ZHVILLIMIT TË RRJETIT TË TRANSMETIMIT

Objektet	Tipi i Përcjellesit (mm <sup>2</sup> )	Gjatësia (km)	Fuqia (MVA)	Viti i Komisioni	Vlera(Euro)
1 Linja 110 kV Uznove - Çorovode dhe dalje 110 kV Uznove	ACSR 240/40	33	122	2015	3,320,000
2 Linja 110 kV Lapaj - Peshkopi dhe dy dalje 110 kV	ACSR 240/40	32	122	2015	3,500,000
3 Blerja e dy AT 220/110/10 kV Burrel	2x 60 MVA	-	120	2015	1,600,000
4 Blerja e nje AT 220/110/35 kV Elbasan	1x120 MVA	-	120	2015	1,200,000
Blerja e nje AT 220/110/35 kV Elbasan	1x120 MVA	-	120	2017	1,200,000
5 Linja 110 kV m e dy qarqe Burrel- Bulqize dhe dy dalje linje 110 kV	2xACSR 240/40	30	122	2018	4,000,000
6 Linje e re 110 kV, Rrashbull-Golem -Kavaje	2xACSR 240/40	18	-	2016	1,700,000
7 Linja m e dy qarqe Ulez- Shkopet - Skuraj;	2xACSR 240/40	10.5		2016	1,800,000
8 Linja m e nje qark Skuraj - Lac-1	ACSR 240/40	12.7		2017	1,800,000
9 Linja m e nje qark Skuraj -Lac-2	ACSR 240/40	10.1			
10 Linja m e dy qarqe Lac2-Lac1	2xACSR 240/40	2.7			
11 Perforcim Linje 110 kV, Lezhe-Laç2	ACSR 240/40	19.5	-	2023	1,700,000
12 Perforcim Linje 110 kV, Ulez-Kurbnesh	ACSR 240/40	23.0	-	2021	2,000,000
13 Linje e re 110 kV, Lapaj-Lure, 2 Dalje linje 110 kV	ACSR 240/40	19.0	-	2023	1,600,000
14 Linje e re 110 kV, Sukth-Gj.Labizit, 2 Dalje linje 110 kV	ACSR 240/40	18.0	-	2022	1,900,000
15 Linje e re 110 kV, Blulqize-Terrmove-Gjorice	ACSR 240/40	20.0		2021	1,900,000
16 220/110 kV Fierze, 1 Dalje Transformatori 220 kV, 1 Dalje Transformatori 110 kV	-	-	2 x 60	2020	2,000,000
17 Linje e re 110 kV, Kukes-Prizren, 1 Dalje linje 110 kV, Nst. Kukes	ACSR 240/40	13.0	-	2018	1,500,000
18 Perforcim Linje 110 kV, Ebasan1-Fiber, Fber-Librazhd	2 x ACSR 240/40	30.0	-	2018	3,000,000
19 Perforcim Linje 110 kV, Ebasan1-GSA-Cerrik-Kajan	ACSR 240/40	24.0	-	2019	2,040,000
20 Perforcim Linje 110 kV, Kajan-Kucove-Marnez-Fier	ACSR 240/40	59.0	-	2019	5,015,000
21 Linje e re 110 kV, Fier-Lushnje	ACSR 240/40	30.0	-	2022	2,400,000
22 Plotësim i qarkut të dytë të linjes 220 kV Fier-Babice-TEC Vlore	ACSR 490/65	35.0	-	2020	1,000,000
23 Linje e re 110 kV, Ballsh-Memalaj-Dragot, N/St. Dragot 220/110 kV	ACSR 240/40	48.0	-	2025	7,080,000
24 Plotësim i qarkut të dytë të linjes 110 kV, Kuçove-Uznove-Çorovode	ACSR 240/40	58.0	-	2023	1,000,000
25 Linje e re 110 kV, Tirana1-Qender(Kabllore), 1 Dalje linje 110 kV.	XPLE-AL1000	2.3		2018	1,500,000
26 Linje e re 110 kV, Koplik-Shkodra1	ACSR 240/40	20	-	2025	1,700,000
27 Linje e re 110 kV, Kosmac-Velpoje	ACSR 240/40	28	-	2024	2,380,000
				<b>TOTALI</b>	<b>285,437,528</b>



**VENDIM****Nr. 213, datë 28.12.2017****MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR  
MIRATIMIN E RREGULLORES “MBI  
KUSHTET SPECIFIKE PËR  
NDËRPRERJEN E FURNIZIMIT ME  
ENERGJI ELEKTRIKE TË KLIENTËVE  
NË NEVOJË”**

Në mbështetje të neneve 16; nenit 84, pika 1, germa d; nenit 95 dhe 96, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” dhe nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2017, mbasi shqyrtoi propozimin e drejtorive teknike mbi fillimin e procedurës për miratimin e rregullores “Mbi kushtet specifike për ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të klientëve në nevojë”,

konstatoi se:

- Neni 96, pika 5, i ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, përcakton se: Furnizuesi, që furnizon me energji elektrike klientin në nevojë, mund të ndërpresë shërbimin, bazuar në kushtet specifike për këtë kategori klientësh, të miratuara nga ERE.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të fillojë procedurën për miratimin e rregullores “Mbi kushtet specifike për ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të klientëve në nevojë”.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI  
Petrit Ahmeti**





	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë  
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 196 lekë